



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10 Korrik 2023

Nr: 689

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**ZGJATJEN E AFATIT TË DENONCIMEVE NR. 407 DHE 409 ID PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE  
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

K O N S T A T O J :

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, bazuar në përcaktimet e nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

-Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Data: 10 Korrik 2023

Nr: 689

Ora: 12:00



“Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 407 dhe 409 ID.”

-Afati që ka Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.

-Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 10.5.2023, është administruar shkresa nga Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, i regjistruar me nr. 407 ID, me lëndë *“Publikim sondazhi”*, me objekt denoncimi *“KQZ publikoi në faqen e saj zyrtare në rrjetet sociale lajmërimin për datën e përfundimit të këtij afati, duke qartësuar se ndalohet publikimi i sondazheve nga data 9 maj deri në përfundim të procesit të votimit. Pra, sikurse është bërë e qartë, sondazhet mund të transmetoheshin deri në datën 8 maj 2023. Lidhur me këtë çështje KRIIK konstatoi në faqen e internetit të Televizionit “Report TV” lajmërimin për publikimin e rezultateve të një sondazhi në datën 9 maj, ç’ka ishte në tejkalim të afatit ligjor.”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 10.5.2023, është administruar shkresa nga organizata Drejtësia Sociale , i regjistruar me nr. 409 ID, me lëndë *“Mosraportim”*, me objekt denoncimi *“Më datë 04.05.2023, ora 16:30, ministri i Kulturës dhe kryetari i bashkisë Tiranë ka zhvilluar një takim në mjediset e hollit të Teatrit të Operas dhe Baletit me artistë të institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës.”*

Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi dministrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

## V E N D O S:

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimeve nr. 407 dhe 409 ID.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**